



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-Kuvendi i Komunës-

01Nr. 60/02-1676/20
Kaçanik, 31.01.2020

Në bazë të Vendimit të KQZ-së, Nr. 38/202 të datës 15.01.2020, më të cilin është caktuar zëvendësimi i anëtarit të dorëhequr, Shpend Krusha me kandidatin e radhës nga po i njëjti subjekt politik LVV, Agim Mani, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 31 Janar 2020, konstatoj:

**Ndryshim Plotësimin e Përbërjes së Kuvendit të Komunës Kaçanik
të Legjislaturës së gjashtë (6) të zgjedhur me 22 Tetor 2017**

- 1. AGIM MANI** – nga subjekti politik “Lëvizja Vetëvendosje- LVV” sipas Vendimit të KQZ Nr.38/202 i datës 15 Janar 2020 (bashkangjitur kësaj shkrese) është emëruar Anëtar (Këshilltar) i Kuvendit të Komunës Kaçanik, në vend të anëtarit të dorëhequr të Kuvendit të Komunës, Shpend Krusha.
- 2.** Betimin për Anëtar të Kuvendit të Komunës, Agim Mani e ka dhënë në mbledhjen e Rregullt të Kuvendit të Komunës më datë: 31 Janar 2020, nga kjo datë realizon të gjitha të drejtat dhe detyrat si anëtarët tjerë të Kuvendit të Komunës, përfshirë edhe kompensimin (paushallin dhe kompensimin për pjesëmarrje në mbledhje).
- 3.** Anëtari i Kuvendit të Komunës Kaçanik nga pika 1 e kësaj shkrese, më rastin e dhënies së Betimit Solemn dhe nënshkrimit të Deklaratës Solemne me 31 Janar 2020, para Kuvendit të Komunës, u zotua se merr përsipër detyrat e anëtarit të Kuvendit Komunal të përcaktuara si në dispozitat e nenit 35.4 të LVL.
- 4.** Mandati i anëtarit të Kuvendit të Komunës është i lidhur më mandatin e Kuvendit të Komunës, fillon nga data e emërimit të tij në këtë post- respektivisht pas dhënies së Betimit Solemn dhe nënshkrimit të Deklaratës Solemne për Anëtar të Kuvendit të Komunës Kaçanik, ndërsa përfundon sipas dispozitave të nenit 37.2 të LVL.
- 5.** Obligohen organet relevante të komunës t’i marrin veprimet e nevojshme për futjen në Listën e Pagave anëtarin e Kuvendit të Komunës, Agim Mani dhe heqjen nga Lista e Pagave, anëtarin e dorëhequr Shpend Krusha.

Me këtë shkresë njoftohen: Kryetari i Komunës- Njësia e Personelit, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

I	Data	31.01/20	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01 Nr. 60/02-1676/20				

- Kuvendi i Komunës -

Në bazë të nenit 35.4 dhe 35.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, anëtar i zgjedhur i Kuvendit të Komunës, e jep Betimin dhe nënshkruan Deklaratën solemne, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 31 Janar 2020, si vijon:

BETIM

Unë, AGIM MANI, "Betohe (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë".

Vendi, Kaçanik,

Data, 31. 01 2020

Emri dhe mbiemri i anëtarit të Kuvendit të Komunës Kaçanik

AGIM MANI

Nënshkrimi




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6, dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Kosovës më 15.01.2020, nxjerr këtë:



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	16.01.20	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	60602-1676	Shtojcë	/

VENDIM

- I. **Z.AGIM MANI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Kaçanik, nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Shpend Krusha.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Agim Mani dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 13.01.2020, Nr.21/2020, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z.Shpend Krusha, pas deklarimit me shkrim të dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye të punësimit jashtë vendit.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatua se, kandidati i radhës në listën e rirenditur i cila është z.Agim Mani, ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidat i radhës, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 15.01.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka